

20160060233

L I G J
PËR NGARKIM TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË ME PJESËN E DYTË TË HUAS
TE BANKA INVESTUESE EVROPIANE SIPAS MARRËVESHJES FINANCIARE PËR
PROJEKTIN PËR NDERTIM TË AUTOSTRADËS SË KORRIDORIT X NË AKSIN
RRUGOR DEMIR KAPI-SMOKVICË

Neni 1

Republika e Maqedonisë ngarkohet te Banka Investuese Evropiane me hua në shumë prej 35.000.000 eurosh, si kofinancim nacional i dedikuar për realizimin e Projektit për ndërtimin e autostradës së Korridorit X, në aksin rrugor Demir Kapi-Smokvicë, që pjesërisht do të financohet nëpërmjet Instrumentit për ndihmë paraaderuese-IPA të Bashkimit Evropian.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshje financiare për Projektin për ndërtimin e autostradës së Korridorit X, në aksin rrugor Demir Kapi-Smokvicë, që do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Investuese Evropiane.

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen financiare nga paragrafi 1 i këtij neni do ta nënshkruajë ministri i Financave.

Neni 3

Huaja nga neni 1 i këtij ligji, do të tërhiqet në më së shumti tri transhe.

Afati i pagesës së çdo transheje të huas mund të jetë prej së paku katër vitesh deri në më së shumti 25 vjet nga data e tërheqjes së transhesë, me grejs periudhë të përfshirë që mund të jetë ndërmjet 60 ditësh dhe shtatë vitesh nga data e tërheqjes së transhesë.

Afati i pagesës së huas do të caktohet për çdo transhe veç e veç, në ditën e dorëzimit të kërkesës për tërheqjen e mjeteve të huas nga Ministria e Financave.

Transheja mund të paguhet edhe në mënyrë të njëhershme në ditën që është ndërmjet tre dhe 15 vitesh nga dita e tërheqjes së transhesë.

Neni 4

Shkalla e kamatës do të përcaktohet për çdo transhe të huas veç e veç, në ditën e dorëzimit të kërkesës për tërheqjen e mjeteve të huas nga Ministria e Financave, varësisht se cila shkallë e kamatës është më e volitshme për Republikën e Maqedonisë (fikse ose variabile).

Neni 5

Projektin do ta realizojë Struktura operative e Ministrisë së Financave-Sektori për financim qendror dhe lidhje të marrëveshjeve, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve dhe Ndërmarrja Publike e Rrugëve Shtetërore.

Neni 6

Republika e Maqedonisë huan nga neni 1 i këtij ligji, do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".